

# MONITORIMI I PROCESIT TË PROKURIMIT FURNIZIMI ME VESHMBATHJE PËR PUNËTORET E KOMUNËS SË GJILANIT 2020



Procedura e përdorur: **E hapur sipas kriterit të çmimit më të ulët.**

**Vlera e parashikuar e kontratës:  
32,125 €.**



Aplikuan: **Tre operatorë ekonomik**, prej të cilëve dy janë shpallur të përgjegjshëm.

**Vlera e nënshkruar e kontratës:  
21,660 €.**

## GJETJET E MONITORIMIT

• Në Planin e Prokurimit **ishin paraparë dy aktivitetet për furnizim me veshmbathje**, njëra me vlerë 10,760 € dhe tjetra 10,375 €. Kurse aktiviteti i prokurimit është iniciuar duke bërë bashkimin e këtyre dy aktiviteteve, që më pas janë ndarë në dy lote, me vlerë të parashikuar të kontratës 32,125 €, apo për 10,990 € më shumë.

• **Nuk ofrohen të dhëna lidhur me artikujt, njësitë dhe sasi të planifikuara që synohen të blihen nga komuna gjatë vitit 2020.**

• **Komuna nuk ka publikuar të plotë kontratën e nënshkruar.** Kontrata është e publikuar vetëm në disa pjesë të ndara dhe mungon pjesa e kushteve të veçanta.

• Nënshkrimi i komisionit për hapjen e tenderëve është vendosur më datë 26 shtator 2020, kurse **hapja e tenderëve është bërë me 29 qershor 2020.**

• **Komuna nuk i ka ofruar qasje KCIC në dokumentet e tenderit të cilat ishin kërkuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.**



## REKOMANDIME

Komuna duhet të trajtoj kërkesën për qasje në dokumente publike të KCIC dhe të nxjerrë vendim lidhur me lejimin apo kufizimin e qasjes në dokumente publike dhe vendimi të përmbajë arsyetimin dhe këshillat juridike.

Komuna duhet të bëjë në mënyrë të qartë dhe cilësore vlerësimin e nevojave dhe planifikimin e prokurimit;

Në platformën “e-prokurimi” të publikohet kontrata e plotë.

Zyrtarët e prokurimit duhet të kujdesen që përmbajtja e dokumenteve të tenderit të jetë identike me njëra-tjetrën dhe të evitojnë gabimet teknike të cilat apriori mund të rezultojnë me flamuj të kuqë;

Komisioni i hapjes së tenderëve duhet të jetë më i vëmendshëm gjatë nënshkrimit të procesverbalit të hapjes në mënyrë që të mos kontestohet besueshmëria e dokumenteve dhe vet integriteti i zyrtarëve pjesëmarrës në hapjen e tenderëve.